



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.09.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 8 korrik 2019.
2. Miratimi i draftkalendarit të punimeve të komisionit për datat 2–20 shtator 2019.
3. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Përpunimin e Farmakopesë Europiane, Strasburg 22. VII. 1964, tekst i ndryshuar në përputhje me dispozitat e protokollit të konventës (EST nr. 134)”.
4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Katarit për transportin detar”.
5. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Eglantina Gjermeni, Evis Kushi, Ralf Gjoni, Andrea Marto, Adnor Shameti, Ervin Bushati, Vasilika Hysi, Ligoraq Karamelo, Eljo Hysko, Rudina Hajdari dhe Vasil Sterjovski.

Mungojnë:

Elona Hoxha, Ditmir Bushati dhe Alket Hyseni.

Të ftuar:

Mira Rakacolli - Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Narvina Sinani - Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

Artan Shkreli - Zëvendësministër për Infrastrukturën dhe Energjinë

Thimjo Plaku - Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Bledar Karoli - Përgjegjës Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Elson Thana - Specialist në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Dajna Sorensen - Zëvendësministre e Ekonomisë dhe Financave

Astrit Kuka – Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Punësimit dhe Aftësimit

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme të datës 10 shtator 2019. Para se të filloj me rendin e ditës, më lejoni t'u uroj sesion të mbarë anëtarëve të këtij komisioni të nderuar dhe mirëseardhjen të gjithë zotërinjve të ftuar, që sot, realisht, na nderojnë me prezencën e tyre për të diskutuar rreth rendit të ditës dhe projektligjeve që kemi mbi tryezë! Kështu që, kolegë të dashur, punë të mbarë!

Fillojmë me rendin e ditës.

Së pari, kemi miratimin e procesverbalit të datës 8 korrik 2019, në qoftë se e kujtoni, sepse ndonjëherë pushimet krijojnë ndonjë moment amnezie, do të thosha, në gjuhën mjekësore. Kështu që shpresoj se të gjithë e kanë lexuar procesverbalin dhe e mbani mend që ka qenë i shkruar në mënyrë korrekte. Nuk ka asnjë kundër.

Miratohet procesverbali.

Përpara keni draftkalendarin e punimeve të komisionit për datat 2-20 shtator 2019, të cilin duhet ta miratojmë. Në qoftë se ju jeni pro këtij kalendari, e konsideroj të miratuar.

Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Karamelo!

Ligoraq Karamelo – Përshëndetje dhe punë të mbarë!

Dua të sjell në vëmendje një kërkesë, që e kam bërë para 4 muajve në lidhje me një problem shqetësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme, pra lidhur me mënyrën se si funksionojnë aty gjërat. Këtu në mbledhje kërkoja, dhe ju e miratuat, që të vinte ministri kushtetues, ose ministri i emëruar ose të tjerët, sepse nuk e dimë se kush drejton aty. Kompetencat janë të ndara dhe nuk dimë çfarë kompetencash ka Kryeministri, ministri i emëruar apo sekretarët, sepse ka sekretar në ministri, por ka edhe në Kryeministri. Zonja kryetare, ky është një problem shqetësues edhe për faktin se ne kemi qenë pak të shkëputur nga problemet e Ministrisë së Jashtme. Me aq sa jam në dijeni, aty ka probleme me trupin diplomatik, si dhe probleme të tjera. Mendoj se komisioni në periudhën në vijim duhet ta përqendrojë vëmendjen edhe në aspektin ekzekutiv. Vërtet ju jeni një shumicë, një maxhorancë e plotfuqishme dhe keni në dorë, pra si të thuash që t'i mbuloni gjërat, por mendoj se ne si komision na takon që t'ju ndihmojmë në këtë aspekt, dhe mund t'ju ndihmojmë, qoftë në problemet që aktualisht përballon ministria, qoftë në problemet që përballon vendi për sa i përket hapjes së negociatave.

Mendoj se roli i Komisionit të Jashtëm nuk duhet të zbehet përpara Komisionit të Integritetit. Ndoshta Komisioni i Integritetit ka një rol një tjetër, por edhe Komisioni i Jashtëm mund të luaj një rol shumë të madh.

Anëtarët e komisionit janë shumë të zotë, duke filluar nga ju, por edhe gjithë të tjerët dhe mendoj se kanë aftësitë e tyre, kështu që do të ishte e mira që në grup ose individëve të veçantë t'u caktohen detyra konkrete, qoftë në drejtim të kontrollit ekzekutiv, qoftë në drejtim të udhëheqjes së punës kolegjiale të ministrisë, qoftë dhe në drejtim të legjislacionit. Në këta 6 muaj që unë jam këtu, komisioni është kthyer vetëm në miratim ligjesh, të cilat i aprovojme dhe mbaron gjithçka. Mendoj se nuk është ky problemi. Problemi është se duhet të thellohem më shumë dhe të kërkojmë më shumë llogari, sepse mendoj se i bëjmë mirë ekzekutivit, punës dhe vendit në këto momente.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Karamelo!

Do të mundohem ta përmbledh atë që ju parashtruat.

Unë kam folur me ministrin në detyrë të Punëve të Jashtme dhe Europës në lidhje me një paraqitje të tij brenda këtij viti për disa çështje, të cilat janë të një rëndësie kardinale për Shqipërinë. Me të drejtë thatë që parlamenti ka Komision të Integritetit dhe, përgjithësisht, duhet që Komisioni përgjegjës për Integritetin ta thërrasë për raportim ministrin e Punëve të Jashtme dhe Europën. Kjo nuk e ndalon as Komisionin e Punëve të Jashtme ta bëjë këtë paralelisht ose bashkërisht me Komisionin e Integritetit.

Nga ana tjetër, unë i kam kërkuar në parim ministrit një raportim në lidhje me punën e deritanishme dhe për detyrimet që do t'i dalin përpara qeverisë shqiptare, e cila shumë shpejt do të marrë drejtimin, presidencën e OSBE-së dhe ky është një detyrim i madh. Shqipëria e merr këtë impenjim për herë të parë dhe duhet të dalë faqebardhë, sepse vendos një tullë të rëndësishme në ngritjen, në përparimin e përfaqësimit të Shqipërisë edhe në strukturat e tjera të një rëndësie edhe më të madhe, siç është kërkesa që Shqipëria ka paraqitur, dhe lobimi që ajo po bën, me qëllim që pak më vite më vonë të marrë një karrige në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara si vëzhgues i përkohshëm. Duke thënë këtë, mendoj se ka ardhur koha që të sintetizojmë një kërkesë zyrtare, e cila duhet t'i drejtohet ministrisë përkatëse për prezencën e ministrit në detyrë, zotit Cakaj, i cili, sigurisht, në një kohë të përshtatshme edhe për të do të vijë të raportojë për një seri çështjesh, që ju ngritët. Ndërkohë, i kam kërkuar atij gojarisht që duhej të përgatitej për këto çështje, duke i dhënë mundësi atij dhe stafit që drejton të mundësojë prezencën e tij këtu. Nga ana tjetër, unë besoj se në ligj është shumë mirë e përcaktuara se si delegohen pushtetet kur kemi një situatë, ku Kryeministri është

njëherazi ministër për Europën dhe Punët e Jashtme, madje shumëçka ai ia ka deleguar ministrit në detyrë. Kështu që nuk besoj se nuk ka ardhur ndonjë pengesë nga kjo gjë, përkundrazi do të thosha që ngritja e një niveli të tillë përfaqësimi e nderon atë institucion, por na nderon edhe ne për atë kohë sa Shqipëria po kalon një proces të rëndësishëm, siç është ai i hapjes së negociatave, e pse jo, edhe ajo e marrjes së Presidencës së OSBE-së, apo shumë më tepër së kaq. Mendoj se për çdo gjë që kemi kërkuar duhet të finalizojmë një kërkesë zyrtare si komision dhe ministri të vijë e të raportojë në një kohë të përshtatshme.

Ne nuk jemi komision mbikëqyrës e as hetimor i punës së ministrisë, sepse ka struktura të tjera që e bëjnë këtë vlerësim, por për çështje të caktuara dhe të një rëndësie të veçantë mund të thirret ministri në detyrë, në çdo moment, për të dhënë sqarime të nevojshme për çdo pretendim, kërkesë, apo dyshim të drejtë që mund të kemi lidhur me çështje, që afektojnë politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë.

Po, zoti nënkryetar.

Ralf Gjoni – Faleminderit, zonja kryetare!

Dëshiroj të shtoj edhe mbështetjen time për kërkesën e drejtë të zotit Karamelo! Në fakt, është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Komisionit të Integritetit, i cili, në dijeninë time, deri më sot është shpërfillur nga ministri në detyrë, zoti Cakaj, por mendoj se duke marrë parasysh kontekstin aktual të integritetit europian, mbledhjen e shumëpritur të Këshillit European 17 tetor për marrjen e vendimit për hapjen ose jo të negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, si dhe duke marrë shkas nga deklaratat e fundit shqetësuese, nëse mund ta shpreh në mënyrë të butë, të Kryeministrit grek për dhunim të të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri, që, të paktën mua si nënkryetar i komisionit, më ka habitur, mendoj se ka ardhur koha që në si komision të jemi më të pranishëm në ushtrimin e kontrollit parlamentar ndaj mënyrës si praktikohet politika e jashtme, veçanërisht politika e fqinjësisë së mirë nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme.

Do të sugjeroja, nëse është e mundur, edhe me dakordësinë e kolegëve tanë të maxhorancës, që para datës 17 tetor, madje do të sugjeroja brenda muajit shtator, të organizonim një dëgjese me ministrin Cakaj, të cilën mund ta bëjmë bashkë me Komisionin e Integritetit, për të diskutuar këto çështje, sepse më duket pak e pavend që ministri të flasë me homologë të nderuar të vendeve europiane dhe të mos shprehet asnjëherë në Komisionin e Jashtëm apo në Komisionin e Integritetit të Kuvendit të Shqipërisë. Mendoj se është në nderin tonë si deputetë ta rrisim rolin kontrollues të Kuvendit ndaj ekzekutivit dhe në këtë rast unë shoh shumë arsye pse duhet ta bëjmë këtë dëgjese.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Jam dakord me ju. Unë do të flas edhe me zonjën Hajdari, e cila drejton Komisionin e Integritetit nëse mund ta realizojmë këtë si një gjë të përbashkët, përndryshe do ta bëjmë vetë dëgjuesën.

Atëherë të miratojmë kalendarin me dëgjuesën me ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme lidhur me gjithçka që folëm deri tani, sigurisht pas përgatitjes dhe materializimit të kësaj kërkesë me një shkresë zyrtare nga ana jonë.

Mimi Kodheli - Kalojmë në projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për përpunimin e Farmakopesë Eropiane, Strasburg 22.07.1964, tekst i ndryshuar në përputhje me dispozitat e protokollit të konventës (EST nr.134)”.

Relatore për këtë projektligj është ish-ministrja Gjermani. Ndërkohë, për të folur dy fjalë shkurtimisht dhe në mënyrë shteruese rreth këtij projektligj, kemi ftuar profesoreshë Rakacollin, Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe zonjën Sinani, Drejtoreshë e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore,

Mirë se vini!

Fjala për ju zonja Rakacolli!

Mira Rakacolli – Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Projektligji që ka sjellë Ministria e Shëndetësisë para komisionit tuaj për vlerësim, i hap rrugë aderimit të Shqipërisë në Komisionin e Hartimit të Farmakopesë Europiane. Konventa Europiane është një dokument, i cili përmbledh standardet e cilësisë që duhen për prodhimin apo për tregtimin e barit ose të lëndës së parë që përdoret për prodhimin e barit. Pra zbatimi i standardeve të kësaj konvente siguron cilësinë në tregun farmaceutik në Shqipëri, një problem ndaj të cilit e gjithë shoqëria është e ndjeshme. Kjo është një konventë e cila daton që në vitin 1948, atëherë kur vendet europiane menduan të hartonin një dokument të tillë për të siguruar cilësinë në vendet e tyre, cilësi e cila u duk në vitet në vijim derisa në vitin 1964 u bë më e plotë kurse në vitet 1992 dhe 1994, pikërisht atëherë kur u krijua Komuniteti European, u fut në dokumentet e detyrueshme të këtij komuniteti.

Standardet e kësaj farmakopeje janë të detyrueshme për t’u zbatuar në 38 në 38 vendet e BE-së, ndiqen nga 100 të tillë, por vendeve, që e nënshkruajnë u hapet rruga nëse e kalojnë në parlament.

Cilat janë të mirat e saj?

Ne kemi materiale të plota në dosjen që kemi përgatitur.

Në radhë të parë siguron standardet për kontrollin e prodhimit të barnave, për kontrollin e cilësisë së lëndës së parë, që punëtori duhet të japë për prodhimin e barit,

përcakton në mënyrë shumë të qartë analizat që duhen bërë për të parë nëse bari është jashtë standardit të farmakopesë, si dhe përcakton e shikon analiza të hollësishme për pjesën tjetër që është inaktive e barit, sepse dihet që kur prodhohet bari shoqërohet edhe me substanca të tjera inaktive. Nëse ne aderojmë në këtë konventë, ku kemi qenë deri tani me statusin vëzhgues dhe kemi zbatuar të tilla gjëra, jo vetën që bëhemi pjesë e BE-së ku synojmë të aderojmë, por dhe u sigurojmë qytetarëve në tregun shqiptar një cilësi shumë më të mirë si në prodhimin ashtu dhe në tregtimin të barnave që përdoren për njerëzit dhe të barnave që përdoren në mjekësinë veterinare.

Me pak fjalë këto janë të mirat që ka vendi nëse nënshkruan këtë konventë. Ky projektligj, pasi është hartuar, ka kaluar në komisione dhe ministri të ndryshme të linjës. Ministria e Punëve të Jashtme ka bërë disa vërejtje, të cilat ne i kemi të përfshira në dokumentin përfundimtar.

Unë jam e gatshme t'i përgjigjem çdo pyetjeje apo paqartësi që mund të ketë dalë nga dokumentet e paraqitura nga ne në lidhje me mënyrën se si funksionon kjo farmakope.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit, profesoreshë!

Fjalën e ka relatorja e projektligjit, zonja Gjermani. Ju lutem shumë shkurt!

Eglantina Gjermani - Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

E para, doja të falënderoja Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për sjelljen e këtij projektligji në parlament! Siç edhe tha edhe zonja zëvendësministre, fakti që Shqipëria nga një vëzhguese bëhet anëtare me të drejta të plota, do të ndikojë pozitivisht në tregun farmaceutik, në tregun e barnave, në sigurinë e shëndetit publik për të gjithë qytetarët dhe në problematikat që ne i hasim çdo ditë në jetën e përditshme. Them se është një garanci më shumë për çështjet e sigurisë së jetës dhe të shëndetit publik. Fakti që 38 vende europiane dhe 100 vende të tjera janë anëtare me të drejta të plota dhe e zbatojnë këtë konventë, jep një garanci më shumë se standardeve, që po u afrohem, janë ato europiane.

Kam vetëm një pyetje, të cilën dua t'ua bëj tani, për faktin që te kjo konventë, ne kemi qenë vëzhgues dhe tani jemi anëtarë me të drejta të plota, sigurisht, kemi përgjegjësi, kemi standarde të tjera, të cilat duhet t'i respektojmë dhe t'i zbatojmë. Dua t'ju pyes vetëm se cili është mekanizmi apo cilët janë mekanizmat, që ju keni në duar për të garantuar zbatimin e kësaj konvente në praktikë për të siguruar realisht cilësi dhe standarde për barnat që përdorin qytetarët shqiptarë?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Urdhëroni!

Mira Rakacolli - Faleminderit, për pyetjen!

Ky propozim vjen, së pari, pasi ne i kemi vlerësuar dhe kemi thënë se i kemi të gjitha mjetet, që mund të ketë një shtet në dorë për ta siguruar këtë cilësi.

Konkretisht: së pari, jemi duke bërë ndryshimet në legjislacion. Shumë shpejt në parlament do të kalojnë edhe ndryshimet në ligjin e barnave, të cilat janë në përputhje me të gjitha masat, që duhen marrë për kontrollin e cilësisë.

Nga ana tjetër, kemi bërë ndryshime të rëndësishme në infrastrukturë, ku po bëhet Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Barnave dhe e Pajisjeve Mjekësore, përveçse po ristrukturohet si agjenci, po bëhet edhe një laborator tejet modern dhe bashkëkohor për analizën e barnave, njëkohësisht, është ngritur dhe strukturuar edhe rrjeti i kontrollit. Kjo nuk është vetëm në letër, por unë kam sjellë edhe shifra këtu për kontrollet që janë bërë deri tani për barnat, për kontrollet që janë bërë nëpër farmacitë e ndryshme, për aparaturat e ndryshme që janë importuar nga kjo agjenci, të cilat kanë qenë gjithmonë konform sigurimit të cilësisë më të mirë, ashtu siç e përmbajnë edhe dokumentet europiane bashkëkohore.

Po them disa shifra që kam këtu: vetëm gjatë vitit 2018 në Laboratorin e Kontrollit të Barnave janë kryer 167 analiza mikrobiologjike dhe 142 fiziko-kimike, që nuk janë pak për një treg farmaceutik, si tregu i Shqipërisë. Janë dhënë 1810 autorizime për import. Autorizimet për import jepen gjithmonë, pasi kontrollohet cilësia, nëse plotësohen standardet e cilësisë nga ato barna të cilat paraqiten... Janë lëshuar 136 autorizime importi për barnat që janë të paautorizuara. Pra, kjo është e rëndësishme, sepse siç e thashë nënshkrimi i Farmakopesë bën të mundur që ne të kemi një protokoll të garantuar të analizës se si bëhet kontrolli i cilësisë për barnat, të cilat nuk janë të përshkruara në këtë Farmakope. Janë përfunduar 349 raporte të kontrollit fizik dhe janë shqyrtuar mbi 50 mijë pulla të kontrollit të barnave, nga të cilat nga sasinë më të madhe e kanë pasur për përdorimin spitalor.

Për sa i përket pajisjeve mjekësore, të cilat kanë hyrë të prokuruar nga kjo agjenci, kanë qenë 406 pajisje nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 286 pajisje kanë qenë nga Italia, 240 pajisje kanë qenë nga Gjermania, 116 pajisje kanë qenë nga Anglia, 150 pajisje nga Kina dhe 106 pajisje kanë qenë nga Franca. Pra, kanë qenë të gjitha pajisje, që kanë ardhur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës apo nga vendet e Bashkimit Europian ...

Nga ana tjetër, është ngritur rrjeti i inspektimit dhe i kontrollit nëpër vendet që prodhojnë dhe tregtojnë barnat, dhe vetëm gjatë muajve të parë të vitit 2019 janë inspektuar dhe janë kontrolluar 652 subjekte farmaceutike, ku nga këto për 150 subjekte janë marra

masa administrative. Pra, fakti tregon që për gati 25% janë marrë masa dhe tregon se ka qenë një kontroll i përgjegjshëm me synimin për ta siguruar cilësinë.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Sigurisht, tryeza është e hapur për pyetje dhe diskutime dhe është e presupozuar që unë, si drejtuese e komisionit, duhet të pyes në fund, por pyetja ime ka të bëjë me diçka, që ju e cekët pak më parë. Thatë se aderimi në Farmakope e detyron Shqipërinë që, për shkak të aderimit të *acquis communautaire* apo shumëçkaje tjetër që e detyron Shqipërinë të ndryshojë legjislacionin në disa drejtime dhe në disa raste.

E di që është shumë e vështirë, megjithatë pyetja ime nuk është retorike. Blerja e barnave i nënshtrohet pa dyshim ligjit të tenderimeve, pra në këtë ligj bëhen përjashtime për shumë pak gjëra, jo domosdoshmërisht për barnat, që do të thotë se bazuar në këtë ligj shteti shqiptar, qeveria shqiptare dhe Ministria e Shëndetësisë blen barna dhe mjete spitalore, age, apo gjëra për të qepur në sallën e operacionit, bazuar kryesisht te çmimi. Sigurisht që ne jemi Komision i Jashtëm dhe duhet ta shohim vetëm nga pikëpamja legjislative se si aderimi në këtë institucion përkon dhe nuk është në kundërshtim me asnjë marrëveshje tjetër që shteti shqiptar ka në fushën e legjislacionit europian ose botëror, ku Shqipëria aderon, por ne mbetemi deputetë dhe jemi pa dyshim të interesuar për çdo shqetësim që vjen, qoftë si qytetarë për aq kohë sa gjithkush nga ne është pacientë te ju. Ka dy gjilpëra që qepin, një të vogël dhe një që e lë shenjë më të madhe, nuk dua ta banalizoj diskutimin, por pyetja ime nuk është retorike, sepse gjilpëra me age kushton më pak dhe prodhohet në një vend që nuk është vend i BE-së, dhëmb më shumë, lë më shumë shenjë, konsumohet më shumë sesa një gjilpërë e vogël. A do të kemi ne ndonjë ditë që tregu ynë, të paktën, t'i përafrohet një tregu të një vendi në Bashkimin Europian, kur flasim për barnat apo për produktet njëpërdorimshme që përdoren? Është e vërtetë që ju keni qenë pjesë e një institucioni, ku sot një ndër aparatet më moderne në botë është pikërisht në këtë institucion, që ne rëndom në gjuhën popullore e quajmë “Spitali 5” dhe ju falënderojmë shumë për insistimin që keni pasur që ky aparat të vijë në Shqipëri dhe patjetër edhe qeverinë që ka shpenzuar aq shumë para për ta sjellë, sepse jo gjithkush e ka, por kjo, në gjykimin tim, nuk mjafton. Unë e di që gjërat duhen bërë hap pas hapi, por në treg mungojnë ilaçe të një cilësie të caktuar apo të një prodhimi të caktuar, në një kohë që e gjithë politika, besoj dhe mendoj, që lidhet me barnat, përtej të gjitha avancimeve pozitive që janë bërë në të gjitha këto vite dhe duhet akoma më shumë të përmirësohet. Nuk po hyj as në skemat e rimbursimit dhe në asnjë skemë tjetër, por thjesht kërkoj që, në qoftë se ka dy lloje aspirinash, një që e prodhon Profarma jonë dhe një që e prodhon, nuk duhet të bëj reklamë, një kompani këtu, duhet t'i kemi të dyja, pastaj, nëse

dua ta marr të rimbursuar, sepse më takon nga skema, jam dakord dhe nëse nuk... E them këtë sepse marr shkas nga testimi i cilësisë së gjërave. Unë nuk them që në Shqipëri shiten barna, të cilat..., jo, fare, përkundrazi, dua thjesht dhe vetëm ta mbështes këtë nismë, e cila daton ekzaktësisht sa unë kam jetë. Pra, na është dashur shumë kohë, për fat të keq, ta bëjmë të mundur aderimin e Shqipërisë në këtë strukturë. A do të mund të vij një ditë, të ndihmuar nga ky aderim, me përmirësimin e mënyrës sesi strukturojmë kontrollin, mënyrës sesi strukturojmë të gjithë listën e ilaçeve, shumë sensitive kjo për publikun, që ne kur të hyjmë në farmaci të mendojmë që nuk jemi në një farmaci në Shqipëri, por në një farmaci kudo në një vend të Bashkimit European? Ndoshta u zgjata shumë në komente dhe pyetje, por dua një përgjigje shumë të shkurtër nga ju nëse...

(Diskutime pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Duhej të isha më shteruese?

(Deputeti Shameti ndërhyr pa mikrofon.)

Gjithmonë nëse mund të marr një përgjigje nga ju.

Mira Rakacolli – Patjetër që kjo është në përputhje me vizionin e ministrisë dhe fakti që kjo është jashtë kuadrit... Përveçse jemi mjekë, jemi edhe pacientë, në kuptimin që edhe ne sëmuremi dhe mjekohemi.

Duke qenë se është në vizionin e ministrisë, edhe ky ligj këtu të çon, te sigurimi i cilësisë.

Në lidhje me atë, se çfarë siguron ky ligj, po marr shembullin që morët ju, një gjilpërë e madhe dhe një e vogël, e rëndësishme është që edhe kjo gjilpërë e madhe dhe kjo e vogla...

Mimi Kodheli – Të jenë brenda standardeve.

Mira Rakacolli – Po, të jenë brenda standardit. Kjo është kryesorja.

Pastaj, a do të kemi këtë gjilpërë?! Më e rëndësishme është që të na bëjë punën që duhet.

Pastaj, diçka që është më konviente, varet edhe nga buxhetet. Është edhe çështje buxheti, por nuk ka asnjë vend në botë, i cili, përfshirë edhe ato përtej oqeanit, të ketë të gjitha medikamentet që ekzistojnë në botë...

Mimi Kodheli – Patjetër.

Mira Rakacolli – Sikur edhe vetëm Farmakope-ja, 3000 medikamente ka. Kjo lista “b” çdo tre vjet...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Pikërisht edhe ndryshimet në ligjin e barnave, edhe ndryshimet që po bëhen aktualisht, në mënyrën se si do të ndikojnë në çmimin e barnave.. Po bëjmë edhe disa

ndryshime në VKM-të sesi do të bëhet ndryshimi i çmimit të barnave që pikërisht me para më pak, domethënë me çmim më të ulët të marrin barin me cilësi më të mirë që ta plotësojë sa më mirë nevojën për të cilën...

Mimi Kodheli – Nevojën për cilësi.

Mira Rakacolli – Po, por cilësia është gjithmonë në përputhje edhe me buxhetin. Ajo që thatë ju ishte shumë e drejtë që konsumatorët, duke përfshirë ne të gjithë, duhet të kemi mundësinë e përzgjedhjes. Një pjesë e mirë e barnave ekziston, pra ekzistojnë disa që ne i quajmë alternativa të para, të cilat rimbursohen 100%. Pastaj, për të njëjtin medikament ekziston në forma.

Ne kërkojmë që njerëzit dhe ne bashkë me ta të kemi sigurinë...

Mimi Kodheli – Bazike.

Mira Rakacolli – ...që baza është cilësore. Gjërat e tjera pastaj, që e bëjnë më konveniente, jo se janë të parëndësishme, por kryesorja është që të...

Mimi Kodheli – Të vijmë hap pas hapi.

Mira Rakacolli – Po, pikërisht siç ishte aparati i rezonancës, që ju e përmendët: një herë ishte më pak efikas, ndërkohë që tani është shumë më i mirë dhe modern.

Po ta kemi vizionin dhe mbështetjen me kalimin e legjislacionit, mund të them që kemi shtruar rrugën, pastaj çdo gjë shkon në rregull.

Mimi Kodheli – Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, unë mendoj që, duke pasur parasysh se kjo konventë është nënshkruar thuajse, në mos gaboj, nga të gjitha vendet anëtare të Bashkimit European, edhe vetë Bashkimi European si organizatë ndërkombëtare, por edhe duke pasur parasysh që ne jemi anëtarë me status vëzhguesi, e shoh si një hap në drejtimin e duhur dhe mjaft pozitiv. Kështu që mendoj se anëtarët e komisionit duhet ta mbështesin. Por ndaj edhe shqetësimin me ju, zonja kryetare, si qytetar i kësaj republike, për një treg farmaceutik të barnave jashtë çdolloj standardi europian, jashtë çdolloj kontrolli sigurie për medikamentet që përdorin të gjithë, edhe fëmijët tanë. Ndaj kam një pyetje teknike për zonjën zëvendësministre. A ndihmon aderimi me të drejta të plota në këtë konventë në eliminimin e barnave, që prodhohen në vendet joanëtare të Bashkimit European, apo edhe jashtë kontinentit europian, që hyn në Republikën e Shqipërisë? Pra, a ka ndonjë efekt real të prekshëm në jetën e qytetarëve kjo konventë për sa i përket origjinës së barnave, që hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë?

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mira Rakacolli – Kjo konventë nuk lidhet me ndalimin e prodhimit në vendet e tjera, por që bari, që hyn në Shqipëri, të jetë cilësor.

Mimi Kodheli – Pra, të respektojë parametrat...

Mira Rakacolli – Nënshkrimi i kësaj bën të detyrueshme që standardet e kësaj konvente janë të detyrueshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur dalin këto standarde, kjo zbatohet në të njëjtën ditë në 38 vende. Pra, e bën të detyrueshme që në atë datë të mos e fusësh. Nuk e kalon prodhimin, por ti nuk e fut, sepse nuk plotëson standardet.

Nuk lejohet tregtimi dhe, njëkohësisht, prodhimi i barnave, se barnat prodhohen edhe në Shqipëri, pra jashtë atyre standardeve.

Ralf Gjoni – E kuptova. Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mira Rakacolli – Dobia tjetër nuk është fakti se këtu përcaktohet vetëm standardi dhe çfarë kushtesh duhet të plotësojë bari, por përcaktohet edhe analiza, mënyra sesi bëhet për ato barna, që nuk janë pjesë e kësaj 3-mijëshe, sepse ka shumë barna...

Ralf Gjoni – E kuptova. Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Mendoj se ka ardhur koha ta hedhim në votë.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Zonja Rakacolli, zonja Sinani ju falënderoj për prezencën!

Punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.09.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Katarit për transportin detar”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Eglantina Gjermani, Evis Kushi, Ralf Gjoni, Andrea Marto, Adnor Shameti, Ervin Bushati, Vasilika Hysi, Ligoraq Karamelo, Eljo Hysko, Rudina Hajdari dhe Vasil Sterjovski.

Mungojnë:

Elona Hoxha, Ditmir Bushati dhe Alket Hyseni.

Të ftuar:

Artan Shkreli - Zëvendësministër për Infrastrukturën dhe Energjinë

Thimjo Plaku - Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Bledar Karoli - Përgjegjës Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Elson Thana - Specialist në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Mimi Kodheli – Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Katarit për transportin detar". Relator është zoti Marto.

Të ftuar janë: zoti Artan Shkreli, zëvendësministër për Infrastrukturën dhe Energjinë.

Mirë se vini zoti Shkreli!

Zoti Thimio Plaku, drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës. Mirë se vini zoti Plaku!

Zoti Bledar Karoli, përgjegjës Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës.

Përsëndetje!

Zoti Elson Thana, specialist në Ministrinë e Infrastrukturës.

Përsëndetje!

Zoti Shkreli nuk është e nevojshme t'ju them të flisni në mënyrë shteruese, sepse ju arkitektët e keni ves t'i zgjasni pak muhabetet, jeni *fly cards* thonë anglezët. Këtë e them si eksperiencë personale, duke ju njohur ju dhe duke pasur dy arkitektë në shtëpi.

Mund të na thoni dy fjalë për projektligjin.

Artan Shkreli – Jemi këtu për projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Katarit për transportin detar", e cila është një monarki, është një gadishull i vogël në Juglindje të Gadishullit Arabik.

Mimi Kodheli – Ja fillove, normal. Në Katar kemi qenë të gjithë për vizitë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Shkreli - Kjo është një marrëveshje kuadër, sikurse e kemi me të gjitha vendet e tjera, madje e vonuar, ka filluar tentativat që në vitin 2015 dhe për shkak të disa pengesave burokratike, fillimisht nga ana jonë pastaj nga ana e Katarit, kjo u shty deri në pranverën e këtij viti. Ardhja e këtij akti të famshëm, ishte një tregues se kjo marrëveshje duhet të kalojë sa më shpejt.

Mimi Kodheli - Ju lutem, afrohuni te mikrofon!

Artan Shkreli – Marrëveshja nuk ka asgjë specifike në raport me marrëveshjet që janë bërë me vendet e tjera. Është një marrëveshje, që në raport me vendet e rajonit ne jemi të vonuar, pasi këta të fundit e kanë miratuar të gjithë marrëveshjen me këtë vend dhe mbi të gjitha nuk ka asnjë efekt financiar për buxhetin e shtetit.

Nga ana tjetër i hap rrugë lundrimin të flotës sonë në territorin e tyre.

Mimi Kodheli - Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Fjalën e ka kolegu, zoti Marto.

Andrea Marto - Faleminderit, zonja kryetare!

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje ashtu siç e tha edhe zëvendësministri synon forcimin e marrëdhënieve ndërmjet të dyja vendeve në fushën e transportit detar. Duke marrë parasysh

parimin e barazisë, të bashkëpunimit dhe të përfitimeve të ndërsjella, marrëveshja bazohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara për ligjin e detit, si dhe në konventat e tjera ndërkombëtare për sigurinë e transportit detar ndërkombëtar, kushtet e jetës dhe të punës së detarëve, transportin e mallrave të rrezikshme dhe mbrojtjen e mjedisit.

Duke qenë se kjo marrëveshje është përgatitur nga Këshilli i Ministrave, në përputhje të plotë me Kushtetutën e me kuadrin ligjor, duke qenë se në aspektin procedural është bazuar në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë, e ftoj komisionin që ta votojë unanimisht këtë marrëveshje.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Marto!

Mirë se vjen, zonja Hajdari!

Një pyetje kam, zoti Shkreli, për ju e për stafin tuaj: në këtë marrëveshje, ose në këtë konventë, në fakt është marrëveshje, a është parashikuar pirateria? Ka disa vende të caktuara të rruzullit, që kanë probleme me piraterinë në det. Shumë prej këtyre vendeve, ose shumë mjete lundruese të këtyre vendeve lundrojnë me një flamur të caktuar, në një kohë që nuk kanë të bëjnë me flamurin me të cilin paraqiten, e kjo për shkaqe piraterie.

A keni menduar ndonjëherë që edhe kjo të jetë pjesë e marrëveshjeve tona, kur flitet për mjete lundrimi? Sepse ky është problem i madh për shumë anije merkantile, për shumë flota, të cilat udhëtojnë jashtë kufijve të bukur të Mesdheut. Meqenëse Shqipëria është:

a-një vend pjesëtar i NATO-s.

b- vend delikat për sa i përket patrullimit detar, që nuk ka të bëjë me patrullimin e forcave detare, por ka të bëjë me arsye të sigurisë, a mendoni ju se do të ishte e nevojshme, që ardhur dita? Ka konventa ndërkombëtare që e rregullojnë këtë marrëdhënie. Ka ngjarje të trishta që lidhen me dëmtimin e shumë njerëzve, të cilët janë kapur peng, si dhe shumë histori, që s'është e nevojshme t'i përmend këtu. Kur do të flitet për këtë gjë?

Faleminderit!

Artan Shkreli – Ky nuk është tipi i marrëveshjes, e cila përfshin këtë problematikë, që për hir të së vërtetës, në mjaft vende është çështje për trajtim. Shqipëria nuk është ballafaquar me probleme të kësaj natyre, e kjo për faktin e thjeshtë se flota jonë nuk e kalon Mesdheun. Ne nuk kemi një flotë e cila shkon në... Gjirit Persik apo të Detit të Kuq...

Mimi Kodheli – Po, por ne kemi anije që shkojnë në Egjipt, kalojnë Suezin.

Artan Shkreli – Është në Mesdhe, bën pjesë në Detin Mesdhe. Nuk kalojnë në Bririn e Afrikës. Kryesisht Briri i Afrikës është zona më problematike për sa i përket edhe piraterisë: Somali e vende të tjera. Megjithatë, kjo marrëveshje është në ratifikim të plotë

edhe të konventave ndërkombëtare. Në një mënyrë apo një tjetër, fakti se është një marrëveshje kuadër, siç e thashë, nuk ndryshon nga marrëveshjet e tjera, jo vetëm tonat, por edhe nga marrëveshjet e tjera kuadër, që ka bërë Bashkimi Europian.

Mimi Kodheli – Pra, ne marrim marrëveshjet copy paste nga çfarë bën Bashkimi Europian.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rastet e fenomenit të piraterisë, jo të flotës sonë, por të atyre tek ne, ka ligje ndërkombëtare, të cilat rregullojnë këtë marrëdhënie, por nuk e di si reflektohet kjo në legjislacionin tonë.

Artan Shkreli – Është një Konventë e cila e trajton këtë gjë. Ne kemi aderuar në atë konventë.

Mimi Kodheli – Kemi aderuar në atë konventë.

Artan Shkreli – Po, kemi aderuar.

Megjithatë, sikurse e theksova në fillim, Katari hyn në ato vende, të cilat kanë legjislacion shumë të përparuar dhe një raport ndërkombëtar të niveleve më të larta. Deri në vitet '70 kanë qenë në Britaninë e Madhe.

Mimi Kodheli – Është partner i mirë i aleancës.

Mirë. Ka pyetje apo diskutime të tjera? Po, zoti Gjoni, të lutem!

Ralf Gjoni – Faleminderit!

Zoti Shkreli, me sa vende të tjera kemi ratifikuar një marrëveshje të tillë?

Mimi Kodheli – Po, zoti Shkreli.

Artan Shkreli - Ratifikimi i marrëveshjes për transportin detar duhej të ishte bërë që në vitin 2015. Në qoftë se doni të dini se cilat janë vendet, mund t'ju them. Ne kemi ratifikuar marrëveshje me Gjermaninë, me Greqinë, me Kroacinë, me Egjiptin, me Bosnjen, me Bullgarinë, me Maqedoninë, me Poloninë, me Rumaninë, me Slloveninë, me Turqinë, me Kinën dhe tani me Katarin. Ne kemi në proces disa marrëveshje të tjera, por, kur të vij momenti, do t'i diskutojmë.

Ralf Gjoni – Nëse ne kemi ratifikuar marrëveshje me këto vende, a keni bërë ju një hulumtim se sa vende të Bashkimit Europian apo vende të pellgut të Mesdheut, të pjesës europiane, kanë ratifikuar një marrëveshje të tillë me Katarin?

Artan Shkreli – Nga informacioni që kemi ne, pjesa europiane e Mesdheut, ku bëjnë pjesë 9 vende, e kanë ratifikuar që të gjithë marrëveshjen me Katarin. Ne mund të jemi vendi i fundit në rajon që nuk e kemi ratifikuar ende këtë marrëveshje. Siç e thashë kjo marrëveshje duhej të ishte bërë që në vitin 2015.

Ralf Gjoni – Në rregull!

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zoti Shkreli, faleminderit!

Unë besoj se është koha që ta hedhim në votim.

Kush është dakord në parim me këtë marrëveshje? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, kolegë!

Faleminderit, zoti Shkreli!

Punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.09.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Eglantina Gjermeni, Evis Kushi, Ralf Gjoni, Andrea Marto, Adnor Shameti, Ervin Bushati, Vasilika Hysi, Ligoraq Karamelo, Eljo Hysko, Rudina Hajdari dhe Vasil Sterjovski.

Mungojnë:

Elona Hoxha, Ditmir Bushati dhe Alket Hyseni.

Të ftuar:

Dajna Sorensen - Zëvendësministre e Ekonomisë dhe Financave

Astrit Kuka - Drejtor i Pagave dhe Pensioneve në Institutin e Sigurimeve Shoqërore

Mimi Kodheli – Së fundi, por jo për nga rëndësia, do të vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë”. Relator i këtij projektligji është kolegu Bushati. Të ftuar kemi zëvendësministren e Ekonomisë dhe Financave, zonjën Sorensen.

Mirë se keni ardhur, zonja Sorensen!

Gjithashtu, kemi të ftuar edhe zotin Kuka. Zoti Kuka, për fat të keq, pozicioni juaj nuk është shënuar këtu. Një nga punonjëset tuaja ka konfirmuar se do të vinit ju të dy, zonjën Sorensen e njohim si zëvendësministre, por ju nuk ju njohim. Çfarë pozicioni keni, ju lutem?

Astrit Kuka – Jam drejtor i Pagave dhe Pensioneve në Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Mimi Kodheli – Në rregull!

Mirë se keni ardhur!

Zonja Sorensen, ky projektligj është shumë i rëndësishëm, por kjo nuk do të thotë se nuk do të jeni shteruese në shpjegimin e tij.

Fjala për ju.

Dajna Sorensen – E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Faleminderit për mundësinë për paraqitjen e këtij projektligji!

Siç ju e përmendët, bëhet fjalë për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë”.

Projektligji është pjesë e procesit të koordinimit të skemave të mbrojtjes shoqërore ndërmjet dy vendeve, i ngjashëm me shumë marrëveshje, që ne kemi nënshkruar edhe me vende të tjera, duke përfshirë këtu: Belgjikën, Luksemburgun, Maqedoninë e Veriut, Hungarinë, Rumaninë, Republikën Çeke, Gjermaninë, Turqinë...

Mimi Kodheli – Neve nuk na duhen këto, sepse na intereson vetëm marrëveshja me Kanadanë.

Dajna Sorensen – Marrëveshja konsiston në ofrimin e përfitimeve të sigurimeve shoqërore dhe bazohet në parimin e trajtimit të barabartë të punëtorëve në punësim, me përfitime dhe të ardhura. Gjithashtu, me anë të kësaj marrëveshjeje, do të garantohen personat, që lëvizin nga një vend në tjetrin, personat në varësi të tyre e të mbijetuarit, të ruajnë të drejtat e fituara apo që janë duke i fituar. Bashkimi i periudhave të siguruara, sipas

legjislacioneve respektive të të dyja vendeve, do të merret në konsideratë për të siguruar të drejtën e përfitimeve dhe llogaritjen e tyre.

Objekt i kësaj marrëveshjeje janë përfitimet nga skema shqiptare e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nga ana kanadeze është akti i sigurimeve për të moshuarit dhe plani i pensioneve. Duhet pasur parasysh se në Kanada ka dy lloje pensionesh: ka pension rezidencial, sikurse ka edhe pension në bazë të kontributeve, që një individ jep gjatë viteve që ka punuar në Kanada.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje ka një rëndësi të veçantë, sepse ne parashikojmë që 60 mijë shqiptarë të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ata që kanë jetuar apo jetojnë në Kanada. Nuk është e domosdoshme që shqiptarët, që janë në Kanada, të kenë punuar, sepse ata do të përfitojnë edhe sikur të mos kenë punuar atje. Në bazë të kësaj marrëveshjeje asnjë qytetar shqiptar apo kanadez që ndodhet në Shqipëri nuk duhet të humbasë asnjë ditë kontribute, pavarësisht se ku kanë punuar, në Shqipëri apo në Kanada, pasi do të mundësohet bashkimi i periudhave të kontributeve në të dyja vendet.

Gjithashtu, një pjesë e rëndësishme e kësaj marrëveshjeje është edhe eksporti i pensioneve. Shqiptarët që jetojnë në Kanada për të eksportuar pensionin e tyre në Kanada duhej të kishin të paktën 20 vjet rezidentë në Kanada, ndërsa në këtë moment, nëse ata kanë 5 vjet rezident në Kanada dhe 15 vjet në Shqipëri, ose 15 vjet në Kanada dhe 5 vjet në Shqipëri, automatikisht këto periudha quhen të njëjta dhe ata mund të vijnë të marrin pensionin lehtësisht këtu, pra është diçka shumë pozitive.

Një tjetër element i rëndësishëm është edhe krijimi i hapësirave ligjore për mbrojtjen e emigrantëve shqiptarë jo vetëm në Kanada, por edhe në vende të tjera, me të cilat kemi marrëveshje dypalëshe.

Pak a shumë kjo është marrëveshja që ne kemi sjellë sot.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Po, kolegu Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Në fakt, ka qenë një kërkesë e hershme e këtij komisioni dhe sot është dita për të falënderuar ministrinë për këtë iniciativë, e cila është shumë e rëndësishme për qytetarët shqiptarë që jetojnë ndërmjet Shqipërisë dhe Kanadasë apo në Kanada.

Shpresojmë që shumë shpejt të mbyllen edhe marrëveshjet e tjera, sidomos me shtetet që ne kemi më shumë marrëdhënie. Për shembull, me Greqinë do të ishte një iniciativë shumë e vlerësuar për shkak të numrit të madh të qytetarëve që kemi atje.

Duke ju falënderuar për mbylljen e kësaj marrëveshjeje me këtë shtet të rëndësishëm, të cilën do ta miratojmë të enjten, të ecim më shpejt edhe me vendet e tjera, me të cilat kemi një ndikim të madh për shkak të numrit të madh të shqiptarëve që kemi atje.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Bushati!

A ka pyetje?

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja kryetare!

Ky projektligj ishte edhe në Komisionin e Ligjeve dhe aty adresuam pyetje që lidhen me aspektet ligjore dhe kushtetuese. Në këtë komision unë kam interes të pyes, e më pas për të rezervuar të drejtën e një diskutimi, lidhur me marrëveshjet e tjera që ju keni në proces diskutimi apo për të cilat ka pasur negociata dhe ecuria e tyre nuk është ajo që duhet. Me cilat shtete jemi në procese konsultive, diskutimi dhe negociimi? Si e shikoni rolin e Komisionit të Jashtëm në këtë proces? Ku do të dëshironi të keni nevojë që të kishit një inkurajim apo mbështetje nëpërmjet punës sonë, si politikbërës?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Po, kolegja Kushi.

Evis Kushi – Pyetja ime është e njëjtë me kërkesën që parashtroi zoti Bushati, por unë dua të di konkretisht se në çfarë faze ndodhen përpjekjet e ministrisë sonë në lidhje me marrëveshjet me Greqinë dhe Italinë.

Duket si një pyetje e përsëritur, sepse në çdo mbledhje të komisionit, kur kemi pasur marrëveshje të tilla, bëhet e njëjta pyetje, por nga mbledhja e fundit kanë kaluar 6 apo 7 muaj dhe ne duam të dimë a janë bërë përpjekje konkrete në këtë periudhë? Cilat janë vështirësitë? A duhet të jemi optimistë apo jo, sepse gjithmonë keni thënë se varet edhe nga pala tjetër, por ndoshta duhet të jemi ne ata që duhet të bëjmë më shumë presion?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Këtë dua të them zonja Sorensen, sepse duket sikur është i parëndësishëm, por një pjesë e pyetjes së zonjës Hysi është shumë e rëndësishme. Pra krijohet ideja se ne jemi komision pritës, ku ju presim, ju pyesim, ju ikni dhe ne e miratojmë. Në këtë komision të nderuar kemi një potencial, i cili duhet të shfrytëzohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa më shumë lojtarë të kemi në fushë në funksion të arritjes së një marrëveshjeje që do të vijë besoj shpejt, sidomos atje ku kemi numrin më të madh të shqiptarëve në Greqi dhe

Itali, kjo do të ishte me të vërtetë një fitore e përbashkët, sigurisht juaja, por modestisht edhe jona.

Fjala për ju.

Dajna Sorensen – Faleminderit!

Kjo pyetje lind natyrshëm për çdo marrëveshje që ne kemi ardhur për të mbrojtur. Kjo pyetje ka interesimin shumë të madh për komunitetet shqiptare në Greqi dhe Itali. Në mënyrë të vazhdueshme ata na kontaktojnë dhe na pyesin për ecurinë e këtyre marrëveshjeve.

Rastet e Greqisë dhe Italisë nuk janë të njëjta, ato janë të ndryshme në problematikën që na ofrojnë.

Për sa i përket Italisë ne kemi pasur diskutim në nivel teknik në vitin 2015, nëse nuk jam e gabuar, në nivel teknik nuk ka në vetvete një problematikë shumë të madhe për arritjen e një marrëveshjeje të mundshme midis dy vendeve.

Gjithashtu edhe kostot financiare në parashikimet tona nuk është se janë kaq substanciale në anën e Italisë. Problematika më e madhe në Itali qëndron se ata nuk janë të gatshëm për të hapur këto lloje negociatash edhe me vendet e tjera, që janë komunitete deri diku më problematike, siç janë marrokenët, që është sikur i hapin një derë të gjitha komuniteteve të tjera pro negociatave. Këtu ka qëndruar hendeku nga ana e tyre, është më tepër një vendimarrje politike, sesa diçka teknike apo që ka kosto të mëdha financiare nga ana e italianëve.

E kundërta në anën e Greqisë, po flasim për një impakt shumë të madh financiar që pala greke në këtë moment nuk është në gjendje për ta marrë përsipër dhe për ta përballuar, ndaj dhe unë kam shprehur disponibilitet për ose diskutime ndaj një marrëveshjeje të mundshme për mbrojtjen shoqërore.

Në rastin e Italisë, Ministria e Jashtme gjithashtu është duke punuar me homologët e vet dhe ka një grup pune që është duke nisur sërish diskutimet me Italinë .

Për sa u përket marrëveshjeve të tjera, ne jemi duke punuar aktualisht për marrëveshjen me Hungarinë, Bullgarinë dhe Malin e Zi. Këto marrëveshje do të fillojnë shumë shpejt, sikurse jemi duke finalizuar marrëveshjen me Zvicrën, që do të vijë shumë shpejt në parlament.

Një element që do të doja ta nënvizoja dhe e përmenda shkarazi, është fakti që për vendet si Italia dhe Greqia nënshkruan marrëveshjen me pothuajse të gjitha vendet e BE-së, është një presion pozitiv që herët apo vonë edhe ato do t'i nënshkruajnë këto marrëveshje, sikurse në rastin me Zvicrën, ne kemi në qoftë se një shqiptar ka vite pune edhe në Greqi, po edhe në Zvicër, automatikisht meqenëse Zvicra ka marrëveshje me Greqinë, vitet e punës

së Greqinë do të njihen. Në qoftë se këtë e bëjmë masivisht edhe me vendet e tjera, po kapim disa segmente...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe në diskutimet që kemi pasur në Bruksel, në lidhje me kapitullin II, për një nga elementet që kemi diskutuar është potencialiteti i marrëveshjeve kuadër me BE-në dhe jo si marrëveshje dosmosdoshmërisht individuale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ralf Gjoni – Jam shumë dakord me mendimin e shprehur nga zonja Hysi dhe shpjegimi i zëvendësministres dëshmon qartë se duhet një koordinim ose një shtytje apo bashkëpunim më intensiv nga ana juaj ndaj nesh, si Komisioni i Jashtëm, duke pasur në konsideratë edhe kontaktet institucionale, por edhe personale që kemi me homologët tanë në këto vende.

Mesa kuptoj, do të ishte e nevojshme një fushatë lobimi shumë e fortë, e cila nuk bëhet dot vetëm nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, por ne si deputetë mund të luajmë një rol proaktiv, sidomos me kolegët tanë deputetë në Romë dhe Athinë.

Do t'ju kërkoja që ndoshta do të duhet të ishit pak më aktivë për të na shtyrë dhe për të na orientuar për rolin që duhet të luajmë në mbështetje të punës suaj në këtë drejtim, kuptohet edhe me ndihmën e zotit Shameti.

Faleminderit!

Adnor Shameti – Patjetër! Jam i gatshëm!

Mimi Kodheli – Nëse nuk ka pyetje dhe komente të tjera...

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit për sqarimin dhe informacionin më të detajuar që dhatë!

Në fakt, e bëra këtë pyetje duke pasur parasysh rëndësinë e këtij komisioni dhe mundësitë që mbart ky komision për shkak të fushës së veprimtarisë që mbulon.

Pajtohem edhe me sugjerimin që bëri kolegu Gjoni, lidhur me rolin që mund të luajnë deputetët e këtij komisioni edhe si drejtues të nënkomisioneve apo komisioneve të tjera, por mbi të gjitha, takimet zyrtare që zhvillon ky komision.

Nga ana tjetër, mendoj se do të ishte shumë e dobishme që të vinte në këtë komision një informacion ku të bëhej e ditur se në çfarë faze janë marrëveshjet me vendet e tjera, duke pasur parasysh edhe rëndësinë që ka mbrojtja e të drejtave të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Çfarë lloj pengesash të karakterit politik, siç ishte rasti i Italisë, këtë tekniken e keni ju, në këtë kuadër, zonja kryetare, mund të kishte një kalendar i takimeve qoftë me

ambasadorë, seanca dëgjimore, sepse ne këtu kalojmë dhe miratojmë të gjithë ambasadorët? Diplomaci nuk është thjesht protokoll, prit dhe përcill delegacione, por ka edhe diplomaci ekonomike, parlamentare dhe ne mund të kontribuojmë shumë, duke u kërkuar edhe ambasadorëve aty për hapat që kanë bërë, sikurse është angazhuar edhe ambasadori Muça në Kanada, i cili ka qenë goxha aktiv. Gjatë një vizite zyrtare vetëm 2-ditore pamë se sa aktiv ishte për të lobuar për çështjet e të drejtave të emigrantëve shqiptarë.

Nga ana tjetër do t'ju sugjeroja, zonja kryetare, në këtë kuadër të merrnim një informacion edhe se çfarë mund të bëjmë ne në kuadër të grupeve të miqësisë, sepse ka shumë grupe të miqësisë, të cilat në Kuvend duhet të jenë më aktive, duke filluar që nga vetja ime, që drejtoj grupin parlamentar të miqësisë Shqipëri-Greqi, sepse ka shumë prej nesh që mund të kontribuojnë në këtë proces.

Së fundi, ne kemi kaluar këtu në komision, ku ka raportuar edhe ministri i Shtetit për Diasporën, një ligj për regjistrimin e shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë territorit, me një buxhet goxha të konsiderueshëm, nëse nuk gaboj rreth 12 milionë, në këtë kuadër, duke inkurajuar edhe shqiptarët nëpërmjet këtyre marrëveshje ne arrijmë të përmbushim edhe regjistrimin e tyre.

Lidhur me atë që tha zonja Sorensen për numrin e shqiptarëve në Greqi, po, është e vërtetë që ka një numër të madh shqiptarësh, por mos harroni se shumica e tyre kanë punuar në të zezë dhe numri i atyre që do përfitojnë do të jetë shumë i pakët. Unë kam një mendim ndryshe, që fatura financiare e atyre që kanë paguar ato..... është shumë i pakët. Unë besoj se me një punë të mirëkordinuar midis grupeve të miqësisë, qeveria, ju si kryetare e komisionit, delegacionet që shkojnë e vijnë, duke përdorur edhe lobizmin me shtetasit shqiptarë, siç ka filluar anketa ose thirrja për të bërë petition e shtetasve shqiptarë në Itali. Besoj se ju e keni parë që këto dy ditë ka një lëvizje të shtetasve shqiptarë në Itali, pasi kanë ndjekur punimet në Kuvendin e Shqipërisë dhe debatin që ne kemi bërë për marrëveshjen me Italinë. Mendoj se duhet ta shkurtojmë kohën dhe do të kemi edhe një rezultat pozitiv.

Unë do të mirëprisja një informacion, nëse do të biem dakord...

Mimi Kodheli – Patjetër.

Vasilika Hysi - ... për ta vënë në dispozicion të sekretarisë së komisionit dhe ne më pas nëpërmjet kryetares dhe sekretarisë të punojmë në komisionet tona, në grupet parlamentare të miqësisë në të gjitha takimet bilaterale apo shumë bilaterale.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Mendoj se është koha për ta hedhur projektligjin në votim. Kush është pro? Kundër?
Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim projektligjin në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Ligji miratohet.

Faleminderit zonja Sorensen dhe zoti Kuka!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA